



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1176/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nazif Reka, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Kaçanik nga subjekti politik AAK-LDD, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar për Kuvend Komunal të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)- Qendra e Numërimit Rezultateve (QNR), për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale të datës 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Nazif Reka, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik AAK-LDD.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Nazif Reka kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Kaçanik nga subjekti politik AAK- LDD, në të cilën pretendon se nga KKZ iu janë konfirmuar 141 vota pa numërimin e votave të tre pikave të vendvotimeve që janë 0701x/02r,0706d/02r si dhe 0710/01d, sipas KKZ nuk i kanë proceduar këto rezultate për shkak të mungesës së materialit, po edhe pas pasimit të të gjithë rezultateve nga Qendra e Numërimit në KQZ nga ky rezultat i KKZ iu kanë hequr 9 vota dhe atë në vendvotimin 0714d/01d dhe supozon se këto vota i kanë kaluar kandidatit tjetër dhe ai kandidat është radhitur më lart se ai. Po ashtu pretenduesi i ankesës thekson se nuk ju kanë proceduar as votat e familjarëve që kanë votuar nëpërmjet postës, dhe për shkak mos procedimit të tyre nuk ka mundur të hyjë në asamble komunale dhe këto vota ju kanë proceduar kandidatit për kryetar komune AAK-LDD. Tahir Qaka.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se i mungojnë votat në tre Vendvotime 0701x/02r, 0706d/02r, 0710/01d dhe 0714d/01d, PZAP-i konstaton se janë të pabazuara dhe të pa argumentuara sepse nuk janë ofruar prova për parregullsinë e pretenduar për të vërtetuar shkeljen e supozuar. PZAP-i, vlerëson se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1176/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.